

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**BLERJE E PAKETES se KATARAKTES**

*(Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 mujor)*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**33140000-3 / Materiale mjekësore të konsumueshme**

**Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) : REF-99021-03-21-2024**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**Vlera e pritshme e kontratave : 7 940 950**, (shtate milion e nenteqind e dyzete mije e nenteqind e pesedhete) leke **pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Fondi limit (vlera e pritshme e kontratatve qe mund te lidhen) : 7 940 950**, (shtate milion e nenteqind e dyzete mije e nenteqind e pesedhete) leke **pa TVSH**

Fondi limit eshte perlllogaritur bazuar ne V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76 nen titullin “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” pika 1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: germa c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe referuar ne rastin konkret Autoriteti Kontraktor ne perlllogaritjen e fondit limit eshte bazuar cmimet e kontratave te meparshme te realizuara nga vete autoriteti (kontrata nr.4736, date 28.09.2022) pasqyruar ne process-verbalin nr.970/1, date 12.03.2024, nga Grupi i punes per perlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, kerkesen me nr.970, date 08.03.2024 te Klinikës se ORL - Okulistikes si dhe bazuar ne kerkesen e Pergjegjeses se Sektorit te Planifikimit dhe Prokurimit nr.996.prot date 12.03.2024*

Financimi i procedures do te kryhet si me poshte :

*Per vitin 2024 vlera e parashikuar e fondit : 3 958 333 (tre milion e nenteqind e pesedhete e tete mije e treqind e tridhete e tre) leke pa TVSH*

*dhe*

Per vitin 2025 vlera e parashikuar e fondit : 3 982 617 (tre milion e nentëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) leke pa TVSH

Kjo ndarje është bërë bazuar në fondin e parashikuar për këto ze për vitin 2024 si dhe nevojave reale të shërbimit të okulistikës për paketën e kataraktës

## **1- Kriteri i përzgjedhjes së fituesit:**

### **B) oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim**

Operatori ekonomik, në plotësimin e formularit të ofertës duhet t'i referohet Fondit Limit Kontratës. Tejkalimi mbi fondin e përcaktuar të Kontratës është kusht skualifikues.

*Kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar bazuar në nenin 87, pika 1, 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 45 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.*

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

### *a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e përcaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."

### *b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilën është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*

### *c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e parashikuar se:

*1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

*2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

### *d. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*

**Argumentimi:** *Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet

**Shënim\*:** Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do të aplikohet mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, .

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Bazuar në nenin 43 pika 2/c dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet :

Neni 43 pika 2/c

*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë : 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence.*

Neni 43 pika 5

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; si dhe në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2024. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)*

## 2.3Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Permbushja e njerit prej kriterëve të mesiperm e ben oferten të vlefshme

**Shënim\*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" nenit 77 pika 4 ku përcaktohet se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; neni 41 pika 3 ku citohet se "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës" dhe neni 55, pika 4/b ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara." dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës". Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :**

Në bazë të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 41 pika 3 ku citohet se "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet

dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” dhe neni 55, pika 4/b ku citohet se: “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.” Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri ka për qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me protoksin azoti që është një produkt tepër specifik në dhenien e shërbimit kundrejt pacientit

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të vetedeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese ose distributor I autorizuar. Te plotësohet në shtojcën 1, formularin e ofertës ose të paraqesë një deklaratë mbi origjinën e mallit (**Firma prodhuese ose distributori i autorizuar dhe vendi i prodhimit**). Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit)

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimi të mallit objekt prokurimi, pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me materiale mjekimi të një natyre tepër të vecante

**2.3.3** Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të cilësive e cila duhet të përkojë me fushën e objektit të prokurimit (*materiale mjekimi*). Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të perkthyer dhe të noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter është në përputhje dhe me pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”.

**2.3.4** Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij.(të përkthyer dhe të noterizuar).

**Argumentim:** Ky kriter vihet në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike (aftësia teknike) ne piken 3 te nenit 40 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku percaktohet se : *3 Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës;*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues. Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”.

**2.3.5** Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogë, ku të përfshihen dhe specififikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (*Pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specififikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen.*) Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do pranohen vetëm në forma elektronike, nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit

**Argumentim:** Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6/b të nenit 40 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku percaktohet se : *6. “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose “ me qellim qe mallrat e furnizuar te jene conform standarteve dhe cilesise se kerkuar, kërkesa për dorëzimin e katalogëve të këtyre mallrave eshte një kërkesë e vendosur në kriteret e vecanta të kualifikimit, i shërben autoritetit për krijimin e një panorame të qartë mbi përpuethshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.6.**Operatori duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të leshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Autorizimi duhet te jete I vlefshem.

**Argumentim:** Ky kriter vihet në përputhje me nenin 21 “Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore” i Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

## **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia e pritshme per 12 muaj</b>
<b>1</b>	Tripan blu me te pakten 0.06% -1ml	flakon	<b>150</b>
<b>2</b>	Viskoelastik Dispersiv; Hydroxy propyl methyl celulose soluci on 2%, -2 ml. Pesha molekulare: 80,000-86,000 daltons; pH: 6.0-7.8. Osmolaliti: 250-350 mosmol/Kg;	Cope	<b>600</b>
<b>3</b>	Viskoelastik Koheziv; 1-1.6% Sodium Hyaluronate me paketim 0.8-1ml; Pesha molekulare: 1.000.000 -3.000.000 daltons pH: 6.8-7.6; Osmolaliti: 260-360 mosmol/Kg;	Cope	<b>300</b>
<b>4</b>	Thika korneale, sklerale per tynel anesor ne forme V, 20 G	Cope	<b>300</b>
<b>5</b>	Thika Korneale, per tynel anesor me tehun prerres 15 <sup>0</sup>	Cope	<b>50</b>
<b>6</b>	Thika Korneale per te realizuar tynelin kryesor, e harkuar me kend, 2,75mm	Cope	<b>250</b>
<b>7</b>	Thika Korneale Kreshente me kend dhe me teh te dyfishte	Cope	<b>25</b>
<b>8</b>	Retraktor Iri si qe realizon dilatim mekanik te pupiles.	Cope	<b>2</b>
<b>9</b>	Lente intraokulare e bute asferike, asimetrike, bikonvekse hidrofobike/hidrofilike se bashku me kartrixh per injektim, me diameter Optik 6-6.5 mm; Gjatesia maksimale 12.5 — 13.5 mm; I gjithe diapazoni I Dioptrive te perfshije nga -7D deri ne + 40D	Cope	<b>300</b>
<b>10</b>	Lente intraokulare e perthyeshme asferike, 3 pjese hidrofobike/hidrofilike bikonvekse se bashku me injektorin njeperdorim per injektim, Diametri Optik 5.5-6mm; Gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm;I gjithe diapazoni I Dioptrive te perfshije nga -7D deri ne + 40D	Cope	<b>25</b>
<b>11</b>	Unaze Kapsulare e hapur me material PMMA me kend 270 grad, Injektori qe perdoret eshte njeperdorimesh	Cope	<b>5</b>
<b>12</b>	Solucjon BSS 500ml me pH 7,2-7,6 dhe me osmolalitet 298-305.	Cope	<b>350</b>
<b>13</b>	Kasete njeperdorimshe per fakoemulsifikim, per prerje 2.85-3.0 mm kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	Cope	<b>255</b>
<b>14</b>	Set vitrektomie anteriore kompatibel bimanual me fako Stellaris ose ekuivalent	Cope	<b>6</b>
<b>15</b>	Maja metalike e drejte 2.85-3.00 mm kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	Cope	<b>20</b>
<b>16</b>	Sliva kompatibel me aparatn kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	Cope	<b>40</b>
<b>17</b>	Ophthalmic surgical drape sterile	Cope	<b>400</b>

Numri i lenteve do të kërkohet nga Shërbimi I ORL OKulistikes në ekzekutimin e kontratës, gjithashtu numrat që nuk do të lëvrohen do të ndërrohen nga operatori ekonomik fitues sipas nevojave të shërbimit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Afati i skadencës: data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës. Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh. Ambalazhi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedure prokurimi.

Specifikimet Teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër të vecantë patentë, vizatim, ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë

e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

**Argumentim:** në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të bërë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Gjithashtu në respektim të bazës ligjore të sipër cituar kudo ku është përmendur një markë e caktuar është vendosur dhe fjala "ekuivalent", kjo e kondicionuar nga aparaturat që disponon Spitali Rajonal Fier.

Specifikimet teknike të materialeve të kërkuara janë vendosur sipas kërkesës nr.970.rott date 08.03.2024 se klinikes se ORL – Okulistikes lidhur me mallrat object prokurimi por dhe nga pervoja e viteve te kaluara

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**